



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:335919
Datë: 18.03.2025
Numri i dokumentit: 07006210

C.nr.4347/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtar Vegim Maloku, në çështjen juridiko-kontestuese të paditëses A.H.nga Peja, të cilën e përfaqëson Njomza Hoxha avokate në Pejë, rruga “Shpëtim Bojku” numër 9, kundër të paditurës G.D.C.CSH.P.K, me seli në rrugën “K. e B.” pn Pejë, baza juridike: Marrëdhënie pune dhe kompensim i pagave dhe diferencës në pagë, vlera e kontestit 5000 euro, jashtë seance me datë 18.03.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET së është tërhequr padia e datës 25.11.2024, e parashtruar nga paditësja A.H.nga Peja, kundër të paditurës G.D.C.CSH.P.K, me seli në rrugën “K. e B.” pn Pejë, baza juridike:Marrëdhënie pune dhe kompensim i pagave dhe diferencës në pagë, vlera e kontestit 5000 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës së saj në këtë gjykatë me datë 25.11.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës, nga baza e kontestit: Marrëdhënie pune dhe kompensim i pagave dhe diferencës në pagë: 5,000 euro.

Gjykata përmes aktvendimit me shenjën C.nr.4347/24, të datës 27.11.2024, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi ndaj të paditurës, ndaj të cilit e paditura është përgjigjur me anë të përgjigjes në padi të datës 10.12.2024.

E autorizuar e paditëses, me parashtrësën e datës 13.03.2025 të dorëzuar pranë kësaj gjykate, e ka bërë tërheqjen e padisë, me arsyetimin se paditësja me të paditurën ka arritur marrëveshje jashtë gjyqësore.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj, përmes komunikimit elektronik me gjykatën me datë 17.03.2025, ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë, duke konfirmuar arritjen e marrëveshjes jashtë gjyqësore me paditësen dhe përmbushjen e detyrimit ndaj të njëjtës.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 261 par. 2, 450 e lidhur me nenin 387, par 1, pika “c” të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:335919, C.nr.4347/24, 18.03.2025**

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktvendimi
nuk është e lejuar ankesa ne kuptim të dispozitës
së nenit 261 par. 4 e LPK-së.

G J Y Q T A R I
Vegim Maloku